

STATUTI& AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGETARE ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Albania Clinic Tattoo” SH.P.K

Themeluesit qe nënshkruan me poshtë:

1. Bashkim Loshaj, i biri i Bedriut, i datëlindjes 26.07.1983, lindur në Kosove dhe banues në Istog, me vendbanim të përhershëm, adresë Rruga Sazani, pranë Plazhit të Vjetër, Vlorë, Rajoni 4, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me pasaportën Nr. 1030313905 , me shtetësi kosovar.

2. Valerie Liliane Moritz, e bija e Guy Pierre Curzio Moritz, e datëlindjes 14.07.1967, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar me shtetësi franceze, banuese në Vlorë me adresë, Rruga “Sazani”, pranë Plazhit të Vjetër, Vlorë, Rajoni 4, identifikuar me nr. pasaportën nr. 15DK19088 .

Sot me datë 12.10.2021, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne përputhje me ligjin Nr. 9901 date 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe Aktin e themelimit te shoqërisë “Albania Clinic Tattoo” vendosën të hartojnë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi te kufizuar “Albania Clinic Tattoo” SH.P.K, në bazë të kushteve që vijnë:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i shoqërisë

- 1.1. Shoqëria ka këtë objekt veprimtarie:
2. Bërja e tatuazheve
3. Tregtimi i artikujve për tatuazhe
4. Pajisje dhe furnizime të ndryshme lidhur me tatuazhet dhe piercing
5. Depilimi me laser (fiber optics)
6. Heqja e tatuazheve

Neni 2. Emërtimi dhe Selia juridike e Shoqërisë

- 2.1. Ortaket vendosen qe shoqërinë ta emërtojë: “Albania Clinic Tattoo” SH.P.K
- 2.2. Selia juridike e Shoqërisë ndodhet ne Vlorë ,në Lagjen “ Pavarësia”,Rruga “ Kosova”, Nr. 2
- 2.3. Shoqëria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3. Regjimi juridik

- 3.1. Shoqëria është Shoqëri me Përgjegjësi te Kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqipëri.
- 3.2. Me vendimin e tij, Ortaket mund te ndryshojnë regjimin juridik te Shoqërisë, në qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

Ne këtë rast, Ortaket do te përshtatin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe ne përputhje me ligjin.

3.4. Shoqëria do te këtë vulën e saj me madhësi te zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqërisë dhe te Ortakëve

4.1. Shoqëria ka te drejte te lidhe marrëveshje dhe te nënshkruajë kontrata ne territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

4.2. Shoqëria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqëri ose ndërmarrje te ndryshme ne Shqipëri ose jashtë saj, ne përputhje me legjislacionin shqiptar.

4.3. Shoqëria përgjigjet ndaj te tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror te derdhur dhe me te mirat e pasurisë se saj.

4.4. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarisë se shoqërisë ne përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nëpërmjet përfaqësuesve te tij.

4.5. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bëjnë me veprimtarinë e Shoqërisë, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

4.6. Ortaket kane te drejte te bëjnë propozime, si dhe te emëroje e shkarkoje administratorin ose administratoret, punonjësit, ekspertin kontabël apo likuidatorët.

4.7. Ortaket përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tij në kapitalin themeltar.

Neni 5. Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është pa afat te caktuar (duke filluar prej datës se regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit (QKB)

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar është 10.000 (dhjetë mijë) Leke, i ndarë në 2 kuota, secili ortak me nga 1 kuote ne masen 50% me vlere 5000 lek secili ortak .

6.2. Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrin Ortaket .

6.3. Ky kapital nuk mund të jetë më i vogël se minimumi që lejon ligji.

Neni 7. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar

7.1. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë.

7.2. Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortakët, personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e ortakut të vetëm.

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

- 8.1. Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKR).
- 8.2. Emërtimi i Shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, NIPT-i duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentet që nxjerr kjo shoqëri dhe që u drejtohen të tretëve.
- 8.3. Organet kryesore të Shoqërisë janë:
 - Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ortakët, njëri prej të cilëve është edhe administratori, eksperti kontabël i caktuar.

Neni 9. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga dy ortakët e shoqërisë, që është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe vendimet e tij janë të detyrueshme.

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga dy ortakët e shoqërisë.

Të drejtën e thirrjes së Asamblesë e kanë Administratori, ose Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamble nëpërmjet një përfaqësuesi, duke qenë i autorizuar me prokurë të posaçme, dhe të marrin vendime vetëm për ato çështje që diskutohen në mbledhjen për të cilën ata kanë marrë të drejtën e përfaqësimit.

Mbledhjet e Asamblesë pasqyrohen në procesverbalin që mbahet me këtë rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortaku i vetëm.

Proces-verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Ortakët e shoqërisë kanë të drejtë të marrin vendime për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 10

10.1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë radhëve të ortakëve të shoqërisë.

10.2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Ortaket.

Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga Administratori i saj **Bashkim Loshaj**, i biri i Bedriut, i datëlindjes 26.07.1983, lindur në Kosove dhe banues në Istog, me vendbanim të përhershëm, adresë Rruga Sazani, pranë Plazhit të Vjetër, Vlorë, Rajoni 4, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e identifikuar me pasaportën Nr. 1030313905, me shtetësi kosovar.

Kohëzgjatja në detyrë e administratorit të shoqërisë do të jetë 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritje në përfundim të mandatit. Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tij, Ortaket vendosin shkarkimin e tij për shkaqe të arsyeshme.

10.3. Administratori i vetëm i ka të gjitha të drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm të Shoqërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj.

10.4. Administratorit të vetëm i takon firma e lirë dhe përfaqësimi i Shoqërisë ndaj të tretëve në veprime, procedura dhe seanca gjyqësore, arbitrazhi ose administrative.

10.5. Administratori është përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo dëme të kryera gjatë ushtrimit të detyrës.

10.6. Kompetencat kryesore të administratorit në Shoqëri janë:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit ;
- raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- administron pasurinë e Shoqërisë, duke përfshirë mjetet financiare, brenda caqeve të lejuara nga ortaku i vetëm.
- kryen të gjitha veprimet bankare në interes të shoqërisë.
- përfaqëson Shoqërinë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e saj dhe mbron interesat e saj në gjykatë apo arbitrazh, nënshkruan kontratat në emër të shoqërisë dhe ndjek zbatimin e tyre.
- i propozon ortakëve për miratim strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe krijimin e organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- i propozon ortakëve për miratim numrin e punonjësve të Shoqërisë, pagat dhe emërimin e shkarkimin e tyre.

Administratori ka të drejtë që brenda funksionit që i jep ligji të delegojë kompetencat një personi tjetër fizik apo juridik nëse për shkaqe objektive nuk mund të ushtroje dot funksionin e tij.

Neni 11. Marrëveshjet e ndaluara

- 11.1. Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktjnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për parardhënie si dhe të bëhen dorëzanës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo masë ndaluese zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjorë të ortakëve që janë persona juridikë.
- 11.2. Kjo masë zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve të personave të cituar në paragrafin e parë të këtij neni, si dhe ndaj çdo personi.

Kreu VI

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 12

- 12.1. Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 12.2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht ekspertit kontabël i autorizuar, miratohen nga Ortakët.
- 12.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 13. Kontrolli i Shoqërisë

- 13.1. Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, i emëruar nga ortaku i vetëm ose të dy së bashku.

- 13.2. Eksperti kontabël i autorizuar garanton që llogaritë vjetore të shoqërisë janë të rregullta, të hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojnë rezultatet e vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqërisë, kontrollon përshtatjen e kontabilitetit me ligjin në fuqi, verifikon përputhjen me llogaritë vjetore të informacionit të dhënë në raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarisë, dokumentet kontabël dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund të aktivizojë ekspertë dhe bashkëpunëtorë për të përballuar volumin e punës, por duke marrë më parë miratimin e ortakëve. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi nga ana e ortakët.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 14

- 14.1. Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitetet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Ortakët
- 14.2. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, ortakët emërojnë një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.
- 14.3. Në fund të procesit të likuidimit, Ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe mbylljen e procesit të likuidimit.
- 14.4. Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuuesit përkatës, likuidatori ndan kapitalet e mbetura për Ortakët të shoqërisë.

Neni 15. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 15.1. Mosmarrëveshjet midis ortakëve, shoqërisë dhe të tretëve në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kreu VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 16

- 16.1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do t'i bëhet referim Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe legjislacionit koherent.
- Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje ne gjuhën shqipe,. Njëra prej kopjeve ruhet në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKET
Bashkim Loshaj
Valerie Liliane Moritz

Bashkim Loshaj

Valerie Liliane Moritz